



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 452 Prot.

Tiranë, më 02.07 2015

VENDIM Nr. 71 datë 23.06.2015

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 41 dhe 43, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.9, të datës 23.06.2015, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Koman"* miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, drejtuese Dr. Elvana Metalla (IA) dhe Dr. Etleva Nallbani (CNRS8167/Orient et Méditerranée, Collège de France, Paris),

VENDOSI:

- I. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Koman"* paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, drejtuese Dr. Elvana Metalla (IA) dhe Dr. Etleva Nallbani (CNRS8167/Orient et Méditerranée, Collège de France, Paris), në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
 - Gërmime në zonën e Shën Gjergjit, zonën 1B (lagja e kishës peshkopale) dhe zonën 1C (zona më e sipërme)
 - Pastrim dhe sondazhe në Gogsh (kisha dhe varreza)
- II. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë 20 korrik-fundi gushtit/nëntor.
- III. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUBINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: www.asha.gov.al